



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.15.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË AGJENCISË
SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare për Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në konsultim me Asistent Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderën, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Valbon Bytyqi, i mbështetur nga, Enver Boqolli (Udhëheqës Ekipi), dhe Ejup Simnica (Anëtar Ekiye).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak	10
4 Qeverisja	11
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	18
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	21


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2014 i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Mbikëqyrësin Kryesor Shtetëror dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat vjetore financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 03.10. 2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj mbi faktin se shpalosja e Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht e besueshme. Regjistri i pasurive fikse nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare ('Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme' dhe 'Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale'), në pajtim me IPSAS në bazë të kontabilitetit të parës së gatshme.


(SNISA 200/1706 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).

Konkluzioni i përgjithshëm

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zbatuar kontrole të brendshme efektive për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet dhe ne kemi marrë siguri nga këto për disa fusha në kuadër të pasqyrave financiare.

Gjatë vitit 2014, ata i kishin kushtuar kujdes të duhur rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm duke adresuar shtatë nga tetë rekomandimet e dhëna. Realizimi i buxhetit ishte në pajtueshmëri më rrjedhjen e parasë, në mbi 98%. Raportimi ishte në përputhje më Legjislacionin. Kontrole efektive vërehen mbi menaxhimin dhe raportimin e obligimeve.

Megjithëse, regjistri kontabël i pasurisë nuk përfshinte të gjitha pasuritë. Konkluzioni dhe rekomandimi ynë kryesor është:



Përgjigja e Menaxhmentit - auditimi 2014

Të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport janë marrë në konsideratë nga Menaxhmenti.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Është përgjegjësi e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ASHMDHP) të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave vjetore financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënia e opinionit:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe kontroll, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien efikase të outputeve cilësore operacionale. Për sistemet individuale financiare ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin funksionojnë kontrollet adekuate. Shembull i një aktiviteti mund të jetë monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operative. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Për këtë nevojitet një vlerësim i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 i cili gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetme ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme, sistemeve të kontabilitetit dhe testeve substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshinë një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të tyre. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

ASHMDHP ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013.

2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm. Regjistri i pasurive fikse nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare ('Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme' dhe 'Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale'), në pajtim me IPSAS në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme.

(SNISA 200/1706 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).

2.2 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

PVF-të e ASHMDHP-së, përfshirë edhe të gjitha kërkesat tjera për raportim duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF – Nr. 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 dhe ndryshim plotësimet e tij;
- Kërkesat e rregullores Nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike;
- Kërkesat e rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare të organizatave buxhetore; dhe
- Kërkesat e procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Lidhur me pajtueshmërinë e kërkesave për raportim të jashtëm, ne nuk kemi çështje për të ngritur.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

ASHMDHP ka adresuar pothuajse të gjitha rekomandimet e dhëna në raportin e auditimit për vitin 2013. Ne inkurajojmë menaxhmentin që të merr masat dhe veprimet e duhura për të adresuar edhe rekomandimet e këtij viti.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e ASHMDHP-së për vitin 2013 ka rezultuar me tetë rekomandime kryesore. ASHMDHP kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohen rekomandimet.

Nga rekomandimet e dhëna, shtatë janë adresuar plotësisht, ndërsa një nuk është adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Qeverisja

Konkluzioni i përgjithshëm

Aspektet kyçe të kornizës së qeverisjes janë adresuar si në vijim nga ASHMDHP-ja:

- Vetëvlerësimi – është kryer në përputhje me rregullat e MFK-së, duke i shërbyer si një pikënisje për të përmirësuar performancën e saj aty ku shihet e nevojshme; dhe
- Raportimi i menaxhmentit – është kryer në baza të rregullta në të cilat është diskutuar në detaje menaxhimi i buxhetit dhe çështje tjera rreth aktiviteteve operative.

ASHMDHP ka zbatuar kontrole të brendshme efektive për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet dhe ne kemi marrë siguri nga këto për disa fusha në kuadër të PVF-ve.

Raportimi ishte në përputhje me Legjislacionin. Kontrole efektive vërehen mbi menaxhimin dhe raportimin e obligimeve.

Përpos progresit, në disa fusha nevojiten përmirësime. Regjistri kontabël i pasurisë nuk ishte azhurnuar në fund të vitit. Si pasojë tri automjete nuk ishin regjistruar në këtë regjistër dhe nuk ishin shpalosur në PVF. Ndërsa nga aspekti i rëndësisë më të ulët kontrole shtesë nevojiten edhe në menaxhimin e shpenzimeve dhe në menaxhimin e pagave.

4.1 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit

Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për ASHMDHP-në dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Burimet e Fondeve:	396,000	375,896	369,682	371,101	281,001
Granti i Qeverisë -Buxheti	396,000	371,700	369,682	361,811	281,001
Donacionet e jashtme	-	4,196	-	9,290	

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

Në vitin 2014, ASHMDHP ka përdorur mbi 98% të buxhet final ose 369,682€, më një rritje prej 1% krahasuar më vitin 2013. Realizimi i mirë i buxhetit vërehet edhe sipas kategorive ekonomike, gjë që tregon një performancë të mirë buxhetore.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Shpenzimi i fondeve sipas kategorive ekonomike:	396,000	375,896	369,682	371,101	281,001
Pagat dhe Mëditjet	184,000	184,000	183,567	159,772	141,724
Mallrat dhe Shërbimet	150,000	137,236	132,739	156,401	105,619
Shërbimet komunale	12,000	4,660	3,486	11,569	7,960
Investimet Kapitale	50,000	50,000	49,890	43,359	25,698

Buxheti final në raport më buxhetin fillestar ishte reduktuar për 20,104€. Reduktimi ishte si rrjedhojë e vendimit të Qeverisë Nr. 07/172 për shkurtime buxhetore për 15% te kategoritë mallra dhe shërbime si dhe komunali.

Buxheti ishte shpenzuar në pajtueshmëri më rrjedhjen e parasë. Realizim pak më i ulët ishte te shërbimet komunale, për shkak se pas vendosjes në objekte publike, këto shpenzime i mbulon Ministria e Administratës Publike (MAP).

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2 Shpenzimet

4.2.1 Prokurimi

Përshkrimi

Rregullat e prokurimit kanë për qëllim të sigurojnë se fondet publike arrijnë vlerën për para përmes aplikimit transparent dhe efikas të tyre.

Ne kemi rishikuar procesin e blerjeve përmes prokurimit për të vlerësuar nëse ASHMDHP ka zbatuar procedurat dhe i është përmbajtur dispozitave të ligjit të prokurimit publik. Ekzaminimet tona audituese kanë përfshirë tërë procesin e prokurimit, nga planifikimi, inicimi, zhvillimi i aktiviteteve të prokurimit, e deri të menaxhimi dhe realizimi i kontratave. Ne identifikuam çështjet në vijim:

Çështja - 1 Nënshkrimi i kontratës më OE të papërgjegjshëm - Prioriteti i mesëm

E gjetura Në dosjen e tenderit, njëra ndër kriteret e kërkuara për nënshkrimin e kontratës ishte dëshmia nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) që operatori ekonomik (OE) nuk ka obligime tatimore të pashlyera.

OE kishte sjellë dëshminë (vërtetimin nga ATK i cili dëshmon gjendjen e obligimeve tatimore të OE), mirëpo në të cekej se OE kishte obligime tatimore të pashlyera. Mungesa e plotësimit të këtij kriteri e bënë të papërgjegjshëm OE në fjalë. Edhe përkundër kësaj ASHMDHP, e kishte shpërblyer me kontratë.

Komisioni i vlerësimit nuk e kishte analizuar përmbajtjen e vërtetimit.

Rreziku Lidhja e kontratave më OE të cilët nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara të përshtatshmërisë rrit rrezikun e një procesi jo efektiv të prokurimit, që rrjedhimisht ndikon në nivelin e të hyrave të shtetit.

Rekomandimi 1 Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë se Komisionet e vlerësimit bëjnë vlerësimin e drejtë të ofertave duke respektuar të gjitha kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit.

Çështja 2 - Realizimi i shpenzimeve pas skadimit të marrëveshjeve - Prioriteti i mesëm

E gjetura ASHMDHP ka lidhur një Memorandum të Mirëkuptimit (MIM) më Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (GJKK) për të shfrytëzuar kontratat e kësaj të fundit për shpenzime që realizohen përmes procesit të prokurimit. Ky MiM kishte skaduar më datën 31 dhjetor 2013, ndërsa një pjesë e shërbimeve ishte kryer pas kësaj date (pagesa e kursit të gjuhës angleze për stafin e agjencisë).

ASHMDHP nuk kishte marrë masa paraprake për të zgjidhur këtë çështje. Me tutje, Zyrtari certifikues në mungesë të alternativave tjera e ka certifikuar si pagesë të rregullt.

Rreziku Furnizimi pas skadimit të marrëveshjeve kontraktuale, rrit rrezikun e furnizimit me mallra ose shërbime jashtë kriterëve dhe specifikave të kërkuara.

Rekomandimi 2 Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet sigurojë proces të mjaftueshëm të menaxhimit të shpenzimeve. Agjencia mundet ose të vazhdojë të përdorë shërbimet e prokurimit të ndonjë subjekti tjetër publik, në kuadër të një kontrate të re, ose të gjejë ndonjë formë tjetër brenda legjislacionit në fuqi.

Çështja 3 - Vonesa në ekzekutimin e pagesave - Prioriteti i mesëm

- E gjetura** ASHMDHP nuk ka arritur të kryejë pagesat në afatin e përcaktuar ligjor. Nga 36 mostra, në nëntë raste pagesat nuk janë realizuar brenda afatit ligjor² prej 30 ditësh pas pranimit të faturës.
- Shkaqet e vonesave ishin mungesa e buxhetit dhe vonesat në alokimin e mjeteve.
- Rreziku** Vonesat në ekzekutimin e pagesave rrisin rrezikun për pagesa shtesë të dëmshpërblimeve ndaj OE. Gjithashtu, mund të rrezikojnë në dështimin e pagesave për mungesë të fondeve dhe bartjen e obligimeve në vitin pasues.
- Rekomandimi 3** Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të siguroj monitorim të vazhdueshëm të procesit të ekzekutimit të buxhetit, me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar me rregulla financiare.

4.2.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrimi

Në kategorinë e shpenzimeve tjera për të cilat nuk nevojitet të zhvillohen procedura të prokurimit, ne testuam 14 mostra, që përfshijnë avancet e udhëtimeve jashtë vendit, shpenzimet e telefonit dhe shpenzimet nga paraja e imët.

Çështja 4 - Pagesa e të punësuarit nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve - Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Neni 31 i Rregullës Financiare nr. 01/2013/MF shpenzimi i parave publike, përcakton kriteret për të përcaktuar nëse personi fizik konsiderohet se është në marrëdhënie pune, ose i përket kategorisë së shërbimeve kontraktuese. Me tutje sipas nenit 33 të gjitha “Organizatave buxhetore duhet të sigurojnë që të gjithë personat në marrëdhënie pune të paguhet përmes listës së pagave”.
- Shoferi personal i Mbikëqyrësit Kryesor Shtetëror, edhe pse i plotëson të gjitha kriteret për t’u konsideruar si person në marrëdhënie pune, edhe më tutje paguhet përmes kategorisë mallra dhe shërbime.
- Pas identifikimit të kësaj çështje në fazën e ndërmjetme të auditimit, menaxhmenti kishte marrë masa të menjëhershme dhe nga muaji dhjetor 2014, të gjithë të punësuarit paguhet përmes listës së pagave.

² Rregulla financiare nr. 01/2013/MF shpenzimi i parave publike, respektivisht neni 37 i saj.

- Rreziku** Pagesat e tilla krijojnë mos pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe si të tilla shpijnë në raportim jo të saktë të shpenzimeve sipas kategorive ekonomike.
- Rekomandimi 4** Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të monitoroj në vazhdimësi kontrollet në menaxhimin e pagave për të siguruar se të gjithë të punësuarit të cilët konsiderohen si persona në marrëdhënie punë sipas rregullës financiare, paguhen përmes listës së pagave.

4.2.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP). Ne kemi rishikuar listat e pagave si dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuara nga Thesari, SIMFK dhe prezantimin e tyre në PVF. Po ashtu kemi testuar disa mostra, duke përfshirë dosjet e personelit dhe procedurat e rekrutimit.

Ne kemi konstatuar së ASHMDHP ka vendosur sisteme të mira të kontrollit mbi këtë kategori të shpenzimeve, më përjashtim të çështjes së identifikuar në vijim.

Çështja 5 - Mospërputhje e titullit të punës në mes listës së pagave dhe Akt emërimeve - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Titulli i vendit të punës në Akt Emërimet e 16 nga 17 të punësuarve të ASHMDHP nuk përputhet me titullin në listën e pagave (Payroll).
- ASHMDHP kishte ndërmarrë veprime për t'i eliminuar këto dobësi, mirëpo MAP-i ende nuk i ka bërë përmirësimet në sistem.
- Rreziku** Kontrollet jo të mira gjatë përgatitjes së listës së pagave rrisin rrezikun që koeficientet e pagës të mos jenë adekuate për vendet e punës, përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë që ushtrojnë.
- Rekomandimi 5** Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të përcjellë veprimet e ndërmarra për t'i eliminuar mospërputhjet mes listës së pagave dhe Akt emërimeve deri në harmonizimin e plotë të tyre.

4.3 Pasuritë dhe detyrimet

4.3.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrimi

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Kjo kërkon procedura të kontrollit dhe menaxhimit të cilat të vërtetojnë ekzistencën e pasurive dhe sigurojnë të dhëna të azhurnuara në përputhje me pasuritë e reja dhe ndryshimet e tjera.

Vlera neto e pasurisë në regjistrin kontabël ishte 38,816€, ndërsa pasuria jo-kapitale me vlerë nën 1,000€ ishte 37,765€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF Nr. 02/2013, për menaxhimin e pasurive jo financiare të organizatave buxhetore.

Çështja 6 - Prezantimi jo i plotë i pasurive në PVF - Prioritet i lartë

E gjetura Bazuar në kërkesat e rregullores MF- nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, ASHMDHP kishte bërë inventarizimin e pasurisë në fund të vitit. Sipas raportit të komisionit vlera e pasurisë mbi 1,000€ ishte 88,279€. Mirëpo, vlera e pasurisë sipas regjistrit kontabël ishte 38,816€, pra me një diferencë 49,463€.

Diferenca ishte si rrjedhojë e mos përfshirjes së tri automjeteve të blera në fund të vitit në regjistrin kontabël.

Rreziku Regjistrimi jo i plotë i pasurisë në regjistrin kontabël do të rezultojë në nënvlerësimin e pasurisë së prezantuar në PVF.

Rekomandimi 6 Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë që regjistrat e pasurisë janë azhurnuar me informata të sakta dhe të plota para përgatitjes së PVF-ve. Me tutje ky regjistër duhet të azhurnohet rregullisht me informatat e reja.

4.3.2 Trajtimi i borxheve

Përshkrimi

Në fund të vitit 2014, obligimet e papaguara të ASHMDHP-së ishin në vlerë 15,886€, që krahasuar me vitin 2013 ishin rritur për 7,411€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2015.

Obligimet kryesisht ishin si rrjedhojë e vonesave në pranimin e faturave, si dhe në mungesë të buxhetit.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

ASHMDHP nuk i plotëson kriteret për të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm.

Sikur në vitin 2013 ashtu edhe gjatë vitit 2014 ASHMDHP kishte kërkuar nga NJAB në kuadër të Ministrisë së Financave të realizojnë shërbimet e auditimit të brendshëm. Megjithatë kjo njësi nuk kishte arritur të mbulojë shërbimet e auditimit gjatë vitit 2014.

Auditimi i fundit ishte bërë gjatë vitit 2013 më temë "Funksionimi i Administratës".

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
2.3. Pajtueshmëria me kërkesat tjera për raportim të jashtëm	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të siguroj përmbushjen e obligimeve të llogaridhënies dhe transparencës përmes raportimit të rregullt dhe me kohë në përputhje me kornizën ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollë.	Po		
3. Rekomandimet e vitit paraprak	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë se plani i veprimit përcakton qartë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve të AP me anëtarë të stafit përgjegjës të identifikuar, dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësishme më të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga Menaxhmenti në baza të rregullta.	Po		
4.2. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të siguroj se me rastin e planifikimit të buxhetit, janë bërë analiza të hollësishme dhe janë identifikuar nevojat reale të shpenzimeve, përfshirë edhe kategorizimin e tyre. Më tutje, të siguroj se të gjitha shpenzimet janë regjistruara në kategoritë ekonomike adekuate.	Po		
4.1.1. Prokurimi	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të rishqyrtoj mundësinë e aplikimit të sistemit fatura mujore (post-paid). Kjo do të siguroj shërbime më efikase me kosto më të ulët.	Po		
4.2.2. Shpenzimet jo përmes prokurimit	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të forcoj kontrollët në procesin e ekzekutimit të pagesave. Ky proces duhet të bëhet në pajtim të plotë me rregulla të thesarit. Gjithashtu, mëditjet duhet të jepen në përputhje të plotë të udhëzimit administrativ për udhëtime zyrtare.	Po		

4.2.2. Shpenzimet jo përmes prokurimit	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të siguroj se gjatë fazës së përgatitjes se buxhetit janë identifikuar të gjitha nevojat për punë jashtë orarit. Më tutje, të forcoj kontrollet në menaxhimin e shpenzimeve për të siguruar se të gjitha pagesat bëhen në pajtim më Ligjin e buxhetit	Po		
4.4.3. Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të siguroj se janë iniciuar procedurat e rekrutimit për të mbuluar pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm.	Po		
4.5.1. Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet sigurojë kontrolle shtesë mbi menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, përfshirë azhurnimin e vazhdueshëm të regjistrit kontabël të pasurisë si dhe funksionalizimin e programit E-pasuria.			Jo, nuk është adresuar.